

Deklaratë e SCiDEV mbi dekriminalizimin sektorial të shpifjes: Standardet evropiane kërkojnë një qasje të përgjithshme

Dekriminalizimi i shpifjes është një element thelbësor për mbrojtjen e lirisë së shprehjes dhe lirisë së medias, të cilat përbëjnë themele bazë të shoqërive demokratike dhe mundësojnë debat të hapur publik dhe pjesëmarrje domethënëse qytetare. Standardet evropiane dhe ndërkombëtare mbështesin gjithnjë e më shumë dekriminalizimin e përgjithshëm si një garanci sistemike për të gjithë pjesëmarrësit në debatin publik, me qëllim çmontimin e efektit frenues që sanksionet penale ushtrojnë mbi shprehjen në interes publik.

Gjatë ndërhyrjes së tij në Konferencën [VII Kombëtare për të Drejtën e Informimit](#), Kryeministri bëri të ditur se qeveria synon të [dekriminalizojë shpifjen vetëm për gazetarët](#), ndërkohë që të ruajë përgjegjësinë penale për funksionarët e zgjedhur në rastet kur ata shpifin ndaj të tjerëve.

Ndërsa mirëpresim synimin për dekriminalizimin e shpifjes, theksojmë se kjo qasje sektoriale krijon një regjim të diferencuar bazuar në statusin e folësit, duke vendosur dallime jo vetëm midis gazetarëve dhe mbajtësve të funksioneve politike, por edhe midis gazetarëve dhe pjesëmarrësve të tjerë në debatin publik, përfshirë qytetarët, organizatat e shoqërisë civile dhe aktorët mbikëqyrës të interesit publik ose rojtarët publik. [Ky formulim](#) duket se e trajton kriminalizimin si një mekanizëm llogaridhënieje për ata që ushtrojnë pushtet publik, ndërkohë që lë të paqartë pozicionin ligjor të folësve që nuk janë gazetarë por që kontribuojnë në diskursin në interes publik.

SCiDEV, së bashku me [Rrjetin SafeJournalists](#), ka qenë vazhdimisht e angazhuar në këtë çështje përmes [kërkimit](#), [analizave ligjore të draft-Kodit Penal](#), kontributeve formale mbi draftet e njëpasnjëshme të reformës, si dhe [pjesëmarrjes së qëndrueshme](#) në [dialogun e strukturuar](#) me aktorët e medias, të lehtësuara nga Bashkimi Evropian dhe Këshilli i Evropës, si edhe në proceset parlamentare. Debati mbi [dekriminalizimin e shpifjes](#) pasqyron një qëndrim të artikuluar prej kohësh nga shoqëria civile, organizatat e gazetarëve dhe aktorët e lirisë së medias në Shqipëri, si dhe nga organizata rajonale dhe ndërkombëtare, dhe është në përputhje me angazhimet e Shqipërisë në kuadër të [procesit të anëtarësimit në BE](#). Për rrjedhojë, diskutimi aktual duhet të kuptohet si vijimësi e një procesi reformues të bazuar në standarde evropiane dhe advokim kolektiv qytetar, dhe jo si një akt diskrecional politik i Kryeministrit.

Megjithatë, dekriminalizimi i kufizuar vetëm tek gazetarët i largohet përpjekjeve advokuese dhe analizave të mëparshme për nevojën e dekriminalizimit të shpifjes. Standardet evropiane për lirinë e shprehjes mbështesin dekriminalizimin e përgjithshëm të shpifjes, dhe jo përjashtime të kufizuara profesionale vetëm për gazetarët. Dispozitat penale për shpifjen krijojnë një efekt frenues mbi shprehjen në interes publik në tërësi dhe rrisin rrezikun e trajtimit të pabarabartë dhe pasigurisë ligjore kur zbatohen në mënyrë selektive. [Jurisprudenca evropiane](#) dhe [standardet e Këshillit të Evropës](#) theksojnë se garancitë për lirinë e shprehjes duhet të mbrojnë të gjithë pjesëmarrësit në debatin publik, përfshirë gazetarët, bashkëpunëtorët e pavarur, aktorët e shoqërisë civile dhe qytetarët, pa kërkuar përkufizime kufizuese të statusit profesional.

Ruajtja e shpifjes penale posaçërisht për funksionarët e zgjedhur nuk kërkohet nga standardet evropiane dhe bie ndesh me parimin se shprehja politike duhet të gëzojë nivelin më të lartë të mbrojtjes në një shoqëri demokratike. Sipas jurisprudencës evropiane, funksionarët e zgjedhur dhe mbajtësit e funksioneve publike pritet të tolerojnë një shkallë më të lartë kritike sesa individët privatë. Ndërsa llogaridhënia për deklarata shpifëse nga ata që ushtrojnë pushtet është legjitime, praktika evropiane favorizon mekanizma civilë, etikë dhe politikë të llogaridhënies, dhe jo sanksione penale, për të shmangur përfshirjen e vazhdueshme të së drejtës penale në rregullimin e shprehjes politike.

Dekriminalizimi i shpifjes duhet të shoqërohet gjithashtu me garanci të forta brenda kuadrit të së drejtës civile, në përputhje me standardet e Këshillit të Evropës. Këto përfshijnë mjete civile proporcionale, mbrojtje efektive të bazuara në interesin publik dhe të vërtetën, pragje më të larta tolerance për kritikën ndaj zyrtarëve publikë, si dhe mekanizma mbrojtës kundër padive abuzive, përfshirë [procedurat e tipit SLAPP](#). Pa këto garanci, shpifja civile rrezikon të marrë karakter ndëshkues dhe të riprodhojë efektin frenues që synohet të eliminohet përmes heqjes së sanksioneve penale.

Në fund, theksojmë se reforma e Kodit Penal, ndonëse e rëndësishme, nuk mund të zgjidhë në vetvete sfidat më të gjera strukturore që ndikojnë lirinë e medias dhe lirinë e shprehjes në Shqipëri. Presioni politik, brishtësia ekonomike e mediave, aksesit në informacion, praktikën rregullatore, vetërregullimi dhe integriteti i medias, si dhe siguria e gazetarëve, kërkojnë një qasje gjithëpërfshirëse dhe sistematike. Dekriminalizimi i shpifjes duhet, për rrjedhojë, të integrohet në një agjendë më të gjerë reformash që synon forcimin e llogaridhënies demokratike, pluralizmit dhe krijimin e një mjedisi mbështetës për gazetari të lirë dhe të pavarur, në përputhje me angazhimet evropiane të Shqipërisë.